



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P- 85/2
Prishtinë, më 13 tetor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 13 TETOR 2009

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqiten deputetët si vijon.

Ramadan Avdiu ngriti shqetësimin lidhur me gjendjen në sistemin e drejtësisë, që nuk është konsoliduar dhe jo rrallë gjykata po shfrytëzohet jo si instrument i drejtësisë, por si instrument i politikës. Ai këtë e ilustroi me gjykimin e fundit ndaj tre ish- luftëtarëve të Zonës Operative të Llapit.

Agim Veliu duke u ndërlidhur në vendimin e Qeverisë së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit, tha se Qeveria e mëparshme para dy vjetësh ka marr një vendim të tillë.

Kuvendi i vazhdoi punimet me këtë:

R e n d t ë d i t ë s

1. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009,
2. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009,
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008.

1. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009

Kryetari njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ia ka paraqitur Kuvendit Raportin gjashtëmujor të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Ai ftoi përfaqësuesin e Qeverisë si propozues që ta marrë fjalën.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, **Ahmet Shala** tha se bazuar në Ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë kemi hartuar Raportin për gjashtëmujorin e parë të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009. Të hyrat e grumbulluara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet në mirëbesim, janë 420 milionë e 85 mijë e 485 euro dhe paraqesin 43,9% të hyrave të përgjithshme vjetore të planifikuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rritje prej 3%.Pra, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje kualitative vjetore të shpenzimeve prej 21,6%. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet, sidomos ekzekutimi i projekteve ishte 30% më i ulët se sa në këtë vit. Investimet kapitale në shumën prej 79 milionë e 360 mijë euro ose 20% e shpenzimeve të përgjithshme karshi me vitin e njëjtë paraprak të njëjtës periudhë, është për 35% më shumë.

Në fund tha se raporti gjashtëmujor është edhe një tregues i mirë i suksesit të institucioneve të Kosovës në këtë periudhë dhe shihet sidomos një përmbushje e planit për grumbullimin e të hyrave dhe tejkalim karshi me vitin e kaluar diku në mesatare mbi 5 – 6%, varësisht në cilin institucion merret periudha krahasuese për gjashtëmujorin e parë. Të gjitha raportet, të gjitha shifrat që janë paraqitur në raport përmbushin standardet e raportimit financiar të përcaktuara me standardet që i ka një shtet i organizuar mirë dhe raporti i plotëson të gjitha kushte tjera sa i përket kualitetit të raportimit konform standardeve evropiane.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, propozoi që Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 të shqyrtohet si një pikë e vetme se bashku me Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për shqyrtimin e dy raporteve si një pikë të përbashkët të rendit të ditës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ... shumica ,
Kundër.....9,
Abstenime.....0.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa që Raporti gjashtëmujor i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 të shqyrtohet se bashku me Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, në një pikë të vetme.

Gani Koci tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar dy raportet dhe për dyja ka rekomandimet e veta. Edhe raporti i përgjithshëm edhe raporti i dytë konsideroj se i përmbushin të gjitha standardet e raportimeve financiare, standardet ndërkombëtare, por edhe rregullat lidhur me raportimin financiar që përcaktohen me Ligjin për menaxhimin e financave publike, prandaj i rekomandoj Kuvendit që t'i miratojë. Ndërsa për raportin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni ka dy qëndrime që mendoj që është mirë Kuvendi rreth këtyre të marrë vendime të caktuara.

Së pari, duke pasur parasysh shpenzimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës në linjën-investimet kapitale, aty kemi një përqindje zero të realizimit të shpenzimeve dhe pikërisht për faktin se tash e tri vjet në këtë linjë figuron projekti Vila Gërmia dhe deri më tani nuk është bërë asnjë hap, as praktik dhe as politik që të realizohet ose të hiqet dorë prej tij. Dhe, në një linjë tjetër, gjegjësisht në linjën paga dhe mëditje të Kuvendit, Komisioni ka kërkuar që të bëhet një ri konfigurim në përputhje në buxhetin e miratuar për vitin 2009, gjë që megjithatë mbetemi me shpresë se kjo çështje do të duhej të realizohej.

Kryetari hapi debatin për Raportit gjashtëmujor të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe Rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadergjona**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik**, si dhe deputetët: **Qamile Morina, Gjylnaze Sylja, Naser Rugova, Gani Geci, Dritan Tali, Riza Smaka, Ardian Gjini, Vezira Emrush, Ibrahim Makolli dhe Gani Koci** dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, **Ahmet Shala**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----44,
Kundër-----19,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, gjegjësisht pikën e parë (1) të rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008

Kryetari njoftoi deputetët se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, konform Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, ia ka paraqitur Kuvendit raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Ai ftoi Kryetarin ose përfaqësuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojnë raportin me rekomandime.

Ne emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci** tha se Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2009, shqyrtoi raportin vjetor të auditorit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe Kuvendit i rekomandon që në seancën plenare ta miratojë raportin vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, me përjashtim të pjesës së raportit të auditimit për Raportin financiar të Radiotelevizioni të Kosovës për vitin 2008. Pas shqyrtimit vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, Komisioni ka konstatuar se raporti i plotëson

standardet ligjore të kontabilitetit për raportim, me përjashtim të raportit të auditimit për raportin financiar të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2009, ka shqyrtuar raportin financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2008, por nuk e ka miratuar me arsyetimin se ai është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe nuk i plotëson standardet e kontabilitetit dhe rregullat tjera të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Kryetari hapi debatin për Raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadergjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Bajram Kosumi**, **Driton Tali**, **Alush Gashi**, **Naser Rugova**, **Rita Hajzeraj**, **Donika Kadaj-Bujupi**, **Ardian Gjini**, kryetari i Kuvendit **Jakup Krasniqi**, **Zylfije Hundozi**, **Ibrahim Gashi**, **Gani Koci**, **Gjylanze Sylja**, **Naim Rrustemi**, **Xhevdet Neziraj** dhe **Synavere Rysha**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari konstatoi se, në mungesë të kuorumit, raporti vjetor i auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, do të votohet në seancën e radhës.

Seanca i përfundoi punimet në orën **19: 50** minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**